



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1499 prot.

Elbasan, me 15.07.2021

**VENDIM**

Nr 32 datë 15.07.2021

**PËR  
PAGESËN E KOMISIONEVE TË NDRYSHME**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 157, VKM nr. 929 datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar, VBA Nr. 8, datë 06.03.2021 "Për miratimin e plan buxhetit të vitit 2021", Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Të paguhen komisionet add-hoc dhe grupet e punës, të ngritura për kryerjen e procedurave në UE, mbi detyrat funksionale të përcaktuara në Statutin e UE-së dhe në rregulloret përkatëse. Pagesa për secilin punonjës të jetë:
  - a) Për KIZ të paguhen me nga 1.5 paga mujore Kryetari dhe sekretari dhe me nga 1 pagë mujore për 5 antarë personel dhe 1 antarë student me 20,000 lekë
  - b) Për KA të paguhen me nga 0.5 pagë mujore për 5 antarë personel.
  - c) Për KZF të paguhen me nga 0.5 pagë mujore për 25 antarë personel dhe 5 studentë antarë me nga 10,000 lekë
  - d) Për komisionet që kanë përgatitur materialet për trajtimin e studentëve të Ciklit të parë me bursë financiare e përjashtimin e tyre nga tarifa vjetore e shkollimit, si dhe përfitimn nga ulja e tarifës vjetore e shkollimit të studentëve të Ciklit të dytë të studimeve, të paguhen me nga 1 pagë mujore 13 antarë personel.
  - e) Për komisionet që kanë përgatitur materialet administrative e financiare të projekteve me financim të huaj, të paguhen me nga 1 pagë mujore 14 antarë personel dhe me 1.5 paga mujore 1 antarë personel.
2. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT  
ARDIAN DURMISHI**